



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

Tiranë më 24 .09.2007

Njoftim për shtyp

Mbi ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2007, shqyrtoi Raportin e Grupit të Punës për përfundimin e procedurës së Hetimit Paraprak dhe rezultatet e inspektimeve të kryera, prej nga konstatoi se ndërmjet ndërmarrjeve prodhuese të betonit në Qarkun e Tiranës është nënshkruar një marrëveshje.

Kjo marrëveshje, e nënshkruar mes ndërmarrjeve "Alba-Beton" Sh.p.k, "Ani" Sh.p.k, "Alban Tirana" Sh.p.k, "Beststar" Sh.p.k, "Beton Expres" Sh.p.k, "Delia", "Eurovin", "Eurobeton" 2005, "Euroline", "Ferro-Beton", "Halili", "Ital-Beton Construction", "Kirchberger", "Kdk", "Qarri", "Tirana-Beton", "Sina 98", "Shkodra Beton", është marrëveshje e ndaluar pasi bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", pasi fikson çmimet e shitjes së betonit sipas markave, rrit çmimet e betonit me 2 euro për metër kub dhe vendos kushte të tjera tregtimi, siç janë ndalimi i kreditimit për firmat ndërtuese të cilat janë debitore ndaj firmave anëtare të Unionit të Prodhuesve të Betonit.

Komisioni i Konkurrencës vlerëson se nëpërmjet kësaj marrëveshje ndërmarrjet përcaktojnë çmime të fiksuara duke vepruar si një organizëm(grupim ndërmarrjesh) i vetëm dhe çenojnë në këtë mënyrë konkurrencën e lirë në treg duke dalë jashtë objektivit të shoqatave të biznesit.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d dhe nenin 45 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", vendosi ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 15.07.2006 ndërmjet ndërmarrjeve prodhuese të betonit në Qarkun e Tiranës. Komisioni ngarkoi Sekretarin e Përgjithshëm për vazhdimin e hetimit për të përcaktuar pasojat e veprimit antikonkurrues dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Autoriteti i Konkurrencës iu bën me dije bizneseve dhe shoqatave që mbrojnë interesat e tyre se realizimi i marrëveshjeve të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrëmbërimin e konkurrencës është një akt i dëmshëm dhe në kundërshtim me ligjin "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".